

***Komentet e FSHU-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së për  
Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Energjisë Elektrike***

---



## I. Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me dt. 07/10/2021 përmes vendimit V\_1424\_2021 aprovoi të Hyrat e Lejuara Maksimale (në vijim, MAR) për Furnizuesin e Shërbimit Universal (në vijim, FSHU) për vitin 2021 në vlerën prej 290 milion €. Megjithëse, MAR-i i aprovuar për vitin 2021 pasqyroi shitjet dhe kostot aktuale për periudhën janar-korrik, si rezultat i çmimeve të larta të importit, të dhënat aktuale për muajt gusht-tetor tejkaluan parashikimet e përdorura gjatë aprovimit të të hyrave të lejuara.

Në përputhje me të drejtën e dhënë në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së me datë 28 tetor 2021, FSHU-ja dorëzoi kërkesën për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, e cila u trajtuar nga Rregullatori vetëm në dhjetor të vitit 2021. Pas dorëzimit të kërkesës së dytë për shqyrtim të jashtëzakonshëm më 28 dhjetor 2021, Rregullatori më 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Tarifave për Energji Elektrike. Në këtë raport Rregullatori ka paraqitur vlerësimin fillestar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Sipas Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e rregulluara për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Përkatësisht, nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit prej 5 %, atëherë bëhet përshtatja e të hyrave të rregulluara. Siç është theksuar edhe në Raportin Konsultativ të Rregullatorit rritja e paprecedent e çmimeve në tregjet e energjisë elektrike ka ndikuar në kostot e blerjes së energjisë elektrike, duke rritur kostot e blerjes së realizuar nga importi. Kjo i ka hapur rrugë fillimit të procesit për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike me qëllim të mbulimit të ndryshimit të ndjeshëm të kostove të blerjes së energjisë elektrike dhe ruajtjes së sistemit elektroenergjetik në vend.

FSHU-ja në vazhdim të këtij dokumenti do të shqyrtojë propozimin e të hyrave të lejuara maksimale sipas Raportit Konsultativ dhe do të prezantoj të dhënat që e mbështesin propozimin e FSHU-së për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën 1 shkurt 2022- 31 mars 2023.

## II. Përshtatja e Kostove të Lejuara

Furnizuesi me Shërbim Universal që nga korriku i vitit 2021 ka vërejtur sinjalet faktike të forta globale të rritjes së çmimeve të energjisë, të cilat tregonin qartë që do të rezultojë në krizë energjetike. Duke parë se situata do të jetë serioze në periudhat në vazhdim, FSHU në komentet e dërguara lidhur me Raportin Konsultativ për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2021 kishte parashikuar çmime më të larta të importi krahasuar me aprovimet e ZRRE-së. Megjithëse siç është theksuar edhe në Raportin Konsultativ për Shqyrtim të jashtëzakonshëm, parashikimi i

FSHU-së ishte për 142% më i ultë krahasuar me realizimet, reflektimi i kërkesës së FSHU-së do të dërgonte sinjale të qarta të çmimeve dhe respektivisht do të rezultonte me shfrytëzim më racional të energjisë elektrike. Gjithashtu, do ta ndihmonte sektorin si nga ana e kostove, ashtu edhe nga ana e likuiditetit të sektorit.

Mos-reflektimi i saktë i kostove realiste të blerjes së energjisë elektrike nga importi gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2021 si dhe mos shqyrtimi me kohë i kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm e vuri Furnizuesin me Shërbim Universal në një pozitë të vështirë financiare, meqenëse kostot e blerjes së importit ishin dyfish më të larta sesa energjia e shitur tek konsumatori fundor. Si rezultat i kësaj gjatë muajit dhjetor u pamundësuan blerjet e energjisë nga importit meqenëse kostot e importit shënuan çmimet më të larta (deri në 600 €/MWh), duke shkaktuar jobalancë të detyruara në sistemin elektroenergetik, të cilat mund të shmangeshin me vendimet adekuate rregullative.




Fig 1. Diferenca ndërmjet çmimit mesatar të blerjeve nga importi dhe çmimit mesatar të shitjes tek konsumatori fundor

Rregullatori në raportin e tij ka theksuar se ka zbritur kostot e jobalancave gjatë pasqyrimin të kostove të lejuara, me arsyetimin se FSHU ka devijuar në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme, megjithatë është e rëndësishme të sqarohet se FSHU ka ngritur vazhdimisht shqetësimin e vet lidhur me kostot e rritura dhe problemet me likuiditetin financiar, duke njoftuar gjithashtu se e ka të pamundur sigurimin e importit. Qëndrimi i rregullatorit që FSHU-ja ka devijuar në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme nuk qëndron sepse kjo dukuri është pasojë e mos-veprimit nga politik-bërësit, duke e lënë sektorin të ballafaqohet me rreziqet e paralajmëruara paraprakisht tek të gjithë akterët. Vlerësimet e tilla te Rregullatorit duhet te trajtohen konform rregulloreve ne fuqi, por ulja e kostove nga ana e rregullatori ne këtë mënyre është ne kundërshtim me Rregullën per Çmimet e FSHU-së.



Në kohën e aplikimit për shqyrtim të jashtëzakonshëm, të dhënat e muajit dhjetor kanë qenë të pa përfunduara. FSHU-ja këto të dhëna i ka dorëzuar tek Rregullatori pas përfundimit të muajit, megjithatë Rregullatori gjatë përshtatjes së kostove të bartshme i ka përditësuar pjesërisht ato. FSHU-ja në këtë dokument ka përditësuar të dhënat e plota për vitin 2021.

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal per vitin 2021	Njësia	Lejuar	Aktuale
Parametrat e indeksimit			
Norma e interesit It	%	5.74.%	
Kostot me pakice te furnizuesit			
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	4.61	4.61
$Zhvierësimi - DEPCt = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.11	0.11
Kostot e bartshme			
Kostot e OST	€m	20.96	21.01
Kostot e OSSh*	€m	105.86	105.86
Fondi BRE**	€m	10.45	10.49
Kapitali punues (WCLCt)			
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFRT_t)$	€m	1.47	1.49
Kostot për blerjen e energjisë			
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	176.98	180.40
Taksa për licencë			
Taksa për licencë	€m	0.04	0.04
Borxhi i keq (BDTA)			
BDTA	%	4%	4%
BDTA	€m	13.64	13.78
Përshtatjet			
Përshtatjet 2019	€m	6.79	6.79
Përshtatjet e të hyrave për FSHU			
MAR-i i Furnizuesit $AAC_{at-1}$	€m	340.89	344.57
Të hyrat aktuale nga faturimi $ARR_{t-1}^{***}$	€m	299.97	299.97
Përshtatjet për interesin e LBT të vitit 2020	€m	0.28	0.28
<b>Përshtatja e të hyrave <math>ADJ_t</math></b>	<b>€m</b>	<b>43.56</b>	<b>47.44</b>

### III. Përshtatja e Kostove të Lejuara

ZRRE-ja në Raportin Konsultativ për Shqyrtim të jashtëzakonshëm ka përdorur shitjet sipas parashikimeve të përdorura në draftin e parë të Bilancit të Energjisë. Megjithëse FSHU duke parë trendin e rritjes së konsumit gjatë vitit 2021 ka dorëzuar raportin e përditësuar të shitjeve, arrë parasysh rritjen e propozuar për tarifatat e konsumatorëve fundor në Raportin Konsultativ të

Strukturës tarifore, FSHU-ja beson se rritja e konsumit nuk do të jetë në përputhje me trendin e viteve të fundit, andaj parimisht pajtohet me propozimin e përdorur nga rregullatori. Megjithatë, FSHU ka përditësuar të dhënat e janarit me qëllim të reflektimit sa më të saktë të kostove dhe të hyrave të pritshme.

Lidhur me shpenzimet Operative, rregullatori gjatë përshtatjes së kostove ka përdorur inflacionin prej 2.12% siç ishte parashikuar nga FSHU para publikimit zyrtar të inflacionit për vitin 2021, i cili rezultoi të jete 5%, prandaj FSHU në këtë raport ka aplikuar normën e saktë të inflacionit të aplikueshëm në eurozonë, siç përcaktohet në Rregullën për Çmimet e FSHU-së.

Lidhur me blerjet e nevojshme për mbulimin e kërkesës për furnizim me energji elektrike, Rregullatori ka përdor skenarin me optimist të prodhimit nga KEK-Gjenerimi e cila pritet të operoj gjatë gjithë muajit mars me 3 njësi të Kosovës A dhe 2 njësi të Kosovës B. Marrë parasysh ndalesat e një pas njëshme të paplanifikuara të njësi gjeneruese gjatë vitit 2021, operimin për një kohë më të gjatë me 3 njësi të Kosovës A, besojmë se skenari i prodhimit është optimist dhe vështirë i realizueshëm. Në këtë kuptim, çdo mungesë eventuale nga plani i prodhimit vendor rrit nevojën për zëvendësimin e tij me import që ka një çmim 10 herë më të lartë sipas çmimeve aktuale të parashikuara në tregun ndërkombëtar për muajin mars. Mbi të gjitha, duke konsideruar edhe ndryshimet e çmimeve të importit dhe paparashikueshmen e tyre, parashikimi i çmimit të importit me një çmim mesatar prej 171 €/MWh është i ultë dhe nuk paraqet kostot reale të pritshme. Për më tepër, Rregullatori në parashikimet e tij nuk i ka konsideruar as çmimet ndërkufitare, të cilat janë rritur dukshëm krahasuar me vitet paraprake dhe të njëjtat shënojnë rritje gjatë sezonit të dimrit, marrë parasysh se të gjitha shtetet e rajonit janë importuese të energjisë elektrike dhe kërkesa për import rritet përtej kapaciteteve të lira ndërkufitare.

Parashikimet e tregjeve ndërkombëtare tregojnë rritjen e çmimeve të importit, të cilat kanë filluar të shënojnë rritje të vazhdueshme nga data 20 janar, siç paraqitet në figurën e mëposhtme.



Fig 2. Trendi i çmimeve të realizuara per periudhën 1-15 Janar 2022



Çmimet e pikut sipas HUPX parashihen të arrijnë 302.47 €/MWh gjatë muajit shkurt dhe respektivisht 283.84€/MWh gjatë muajit mars<sup>1</sup>, për të mos shënuar rënie më pak se 269.61 në tremujorin e 4-të të vitit 2022. Në këtë kuptim, marrë parasysh të lartë-thënat, në dokumentin në vijim, FSHU ka konsideruar çmimin mesatar prej 250 €/MWh për blerjet nga importi, sipas skenarit optimist të KEK-Gjenerimit.

Meqenëse deri në momentin e dorëzimit të këtij raporti nuk ka vendim për subvencionimin e energjisë elektrike dhe nuk janë të njohura modalitetet e ofrimit të këtij subvencionimi, FSHU nuk mund të paragjykojë të njëjtët.

Sa i përket kostove të bartshme për FSHU-në (kostot e OSSH-së dhe OST-së), ato prezantohen sipas parashikimeve të ZRRE-së meqenëse të njëjtat janë të panjohura nga FSHU në kohën e aplikimit. Komenti i ZRRE-së lidhur me parashikimin e kostove të OSSH-së në raportin konsultativ ka qenë i paqartë. Për sqarim, FSHU në Raportin Konsultativ ka parashikuar rritjen e kostove të OSSH-së dhe OST-së njëtrajtësisht me rritjen e FSHU-së. Ndërsa, në këtë dokument FSHU i paraqet ato ashtu siç janë parashikuar nga Rregullatori në Raportin Konsultativ për shqyrtim të jashtëzakonshëm.

---

<sup>1</sup> HUDEX, Parashikimi Çmimeve të importit sipas dt. 26 janar 2022 <https://hudex.hu/en/market-data/power/daily-data#month>

#### IV. Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në për vitin 2022

Tabela e mëposhtme përmbledh MAR-in e kërkuar nga FSHU-ja për vitin 2022, pas marrjes në konsideratë të të gjitha përshtatjeve të nevojshme, ashtu siç janë argumentuar më lartë.

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal për vitin 2022	Njësia	Propozimi ZRRE	Propozimi FSHU
<b>Parametrat e indeksimit</b>			
Norma e interesit It	%	5.53%	5.53%
<b>Kostot me pakice te furnizuesit</b>			
OPEX - $OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.29	5.42
Zhvlerësimi - $DEPCt = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.11	0.11
<b>Kostot e bartshme</b>			
Kostot e OST	€m	18.34	18.34
Kostot e OSSh*	€m	174.50	174.50
Fondi BRE**	€m	3.54	3.54
<b>Kapitali punues (WCLCt)</b>			
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPCt + PSTCt - NTFRt)$	€m	2.22	2.31
<b>Kostot për blerjen e energjisë</b>			
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	186.10	203.30
<b>Taksa për licencë</b>			
Taksa për licencë	€m	0.07	0.07
<b>Borxhi i keq (BDTA)</b>			
BDTA	%	2.4%	2.4%
BDTA	€m	12.52	13.13
<b>Përshtatjet</b>			
Përshtatjet 2021	€m	43.56	47.44
Përshtatjet për OPEX	€m	0.42	0.42
<b>Përshtatjet e të hyrave për FSHU</b>			
MAR-i i Furnizuesit $AAC_{at-1}$	€m	446.67	468.46
Të hyrat aktuale nga faturimi $ARR_{t-1}^{***}$	€m	314.33	319.82
<b>Përshtatja e të hyrave <math>ADJ_t</math></b>	<b>€m</b>	<b>446.67</b>	<b>468.60</b>

Me qëllim të reflektimit të kostove të pritshme të nevojshme për operim të sigurt të FSHU-së nevojiten 468.59 milion €. Të hyrat e pritshme nga shitjet me tarifatat aktuale janë 319.82 milion €, pra sistemit i duhet një rritje tarifore prej 47% mesatarisht.

Çdo reflektim më i ultë se kostot e kërkuara do ta rrezikoj operimin e qëndrueshëm të FSHU-së i cili gjatë vitit 2021 tashmë është përballur me probleme likuiditeti.



Ndërtesa e Elektrokosoves    Elektrokosova Building  
Bulevardi Bill Klinton nr.3    Bill Clinton Boulevard no.3  
Prishtinë 10000    Prishtina 10 000  
Republika e Kosoves    Republic of Kosovo

## ***USS Comments on the ERO Consultation Report for Extraordinary Review of Electricity Tariffs***

---

January, 2022



## **I. Introduction**

Energy Regulatory Office dated 07/10/2021 through decision V\_1424\_2021 approved the Maximum Allowed Revenues (hereinafter, MAR) for the Universal Service Supplier (hereinafter, USS) for the year 2021 in the amount of € 290 million. Although the approved MAR for 2021 reflected actual sales and costs for January-July, as a result of high import prices, the actual data for August-October exceeded the forecasts used during the approval of allowed revenues.

In accordance with the right given in the USS Pricing Rule, on October 28, 2021, USS submitted the request for opening an extraordinary review, which was handled by the Regulator only in December 2021. After submitting the second request for extraordinary review on December 28, 2021, ERO on January 17, 2022 has published the Consultative Report for Extraordinary Review of Electricity Tariffs. In this report ERO has presented the initial assessment for the Maximum Allowed Revenues for the Universal Service Supplier.

According to the USS Pricing Rule, during the extraordinary reviews the impact of the extraordinary event on the regulated revenues for the rest of the regulatory period is calculated. Respectively, if the impact is higher than the materiality threshold of 5%, then the regulated revenues are adjusted. As noted in the ERO Consultation Report, the unprecedented increase in prices in the electricity markets has affected the costs of purchasing electricity, increasing the costs of purchases made from imports. This paved the way for the start of the process for extraordinary review of electricity tariffs in order to cover the significant change in the costs of purchasing electricity and maintaining the electricity system in the country.

In this document, USS will review the proposal of maximum allowed revenues according to the Consultation Report and will present the data that support the proposal of USS for maximum allowed revenues for the period 1 February 2022- 31 March 2023.

## **II. Adjustment of Allowed Costs**

The Universal Service Supplier since July 2021 has observed strong factual global signals of increasing energy prices, which clearly indicated that it would result in an energy crisis. Seeing that the situation will be serious in the following periods, USS during the submission of comments on the Consultation Report on the maximum allowed revenues for 2021, had predicted higher import prices compared to the approvals of ERO. Although as stated in the Consultation Report for Extraordinary Review, the forecast of USS was 142% lower compared to the realizations, the reflection of the request of USS would send clear price signals and respectively would result in more rational use of electricity. It would also help the sector both in terms of costs and in terms of sector liquidity.

Inaccurate reflection of the costs of purchasing electricity from imports when determining the maximum allowed revenues for 2021 as well as delays to take action regarding the request for extraordinary review put the Universal Service Supplier in a difficult financial position, since the purchase costs of imports were twice as high as the energy sold to the final consumer. As a result, during December, import purchases of energy were impossible to be purchased, considering that import costs marked the highest prices (up to 600 € / MWh), causing imbalances in the electricity system, which could be avoided if adequate regulatory measures were taken.




Fig 1. Difference between average price for import purchases and average price sold to end-customers

ERO in its report stated that it has reduced the costs of imbalances in reflecting the allowed costs, with justification that USS has deviated systematically and intentionally, however it is important to clarify that USS has consistently raised its concerns about increased costs and problems with financial liquidity, also announcing that it is impossible to insurance imports. The stance of ERO that USS has systematically and continuously deviated does not stand because this phenomenon is a consequence of inaction by policy makers, leaving the sector to face the risks warned in advance to all relevant stakeholders. Such evaluations from the Regulator should be treated conform legislation in power, but decreasing imbalance costs in this way is in contradiction with the Pricing Rule for USS.

At the time of the application for extraordinary review, the December data were incomplete. USS has submitted this data to the Regulator after the end of the month, however ERO has partially updated the same during the adjustment of pass-through costs. USS in this document has updated the full data for 2021.



Universal Service Supplier MAR of 2021	Unit	Allowed	Actual
Indexation parameters			
Interest Rate $I_t$	%	5.74.%	
Retail Costs of the Supplier			
OPEX - $OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	4.61	4.61
Deprecation - $DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.11	0.11
Pass-through costs			
TSO costs	€m	20.96	21.01
DSO costs*	€m	105.86	105.86
RES fund**	€m	10.45	10.49
Working capital (WCLC <sub>t</sub> )			
$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	1.47	1.49
Energy purchase costs			
Wholesale energy purchase costs	€m	176.98	180.40
Licensing Tax			
Licensing Tax	€m	0.04	0.04
Bad dept (BDTA)			
BDTA	%	4%	4%
BDTA	€m	13.64	13.78
Adjustments			
Adjustments 2019	€m	6.79	6.79
Adjustments of revenues for USS			
USS MAR $AAC_{at-1}$	€m	340.89	344.57
Actual revenues from billing $ARR_{t-1}^{***}$	€m	299.97	299.97
Adjustments for interest of LBT for year 2020	€m	0.28	0.28
<b>Adjustments of revenues <math>ADJ_t</math></b>	<b>€m</b>	<b>43.56</b>	<b>47.44</b>

### III. Adjustment of Allowed Costs

ERO in the Consultation Report for Extraordinary Review has used the sales according to the forecasts used in the first draft of the Energy Balance. Although USS seeing the trend of increasing consumption during 2021 submitted the updated sales report, considering the tariff increase proposed by ERO in the Consultative Report of the Tariff Structure, USS believes that the increase will not be in line with the trend of recent years, therefore in principle agrees with the proposal of ERO. Yet, USS updated the January data in order to reflect as accurately as possible the expected costs and revenues.



Regarding Operating Expenses, regulator during the adjustment of costs used the inflation of 2.12% as predicted by USS before the official publication of inflation for 2021, which turned out to be 5%, therefore USS in this report has applied the correct inflation rate applicable in the euro area, as defined in the Pricing Rule for USS.

Regarding the necessary purchases to cover the demand for electricity supply, the ERO has used the most optimistic production scenario from KEK-Generation which is expected to operate throughout March with 3 units of Kosovo A and 2 units of Kosovo B. Considering the unplanned one after the other of the generating unit during 2021, the operation for a longer time with 3 units of Kosovo A, we believe that the production scenario is optimistic. In this sense, any eventual absence from the domestic production plan increases the need for its replacement with import which has a price 10 times higher than the actual prices forecast in the international market for March. Above all, considering the changes in import prices and their unpredictability, the forecast of the import price with an average price of 171 €/MWh is low and does not represent the real expected costs. Moreover, the ERO in its forecasts has not considered cross-border prices, which have increased significantly compared to previous years and the same increased during the winter season, given that all countries in the region are importers of electricity and demand grows beyond free cross-border capacities.

International market forecasts show an increase in import prices, which have started to increase steadily from January 20, as shown in the figure below.



Fig 2. Trend of import price for the period of 1-25 January 2022

Peak load prices according to HUPX are projected to reach 302.47 €/MWh during February and respectively 283.84 €/MWh during March<sup>1</sup>, not to decline less than 269.61 in the 4th quarter of 2022. In this sense, take into account above said, in the following document, FSHU has considered the average price of 250 €/MWh for import purchases, according to the optimistic scenario of KEK-Generation.

Since the moment of submission of this report there is no decision on electricity subsidy and the modalities of providing this subsidy are not known, USS cannot prejudge the same.

<sup>1</sup> HUDEX, Forecast of Import Prices date January 26, 2022 <https://hudex.hu/en/market-data/power/daily-data#month>

Regarding the pass-through costs for USS, (DSO and TSO costs) are presented according to ERO forecasts as the same are unknown by USS at the time of application. ERO's comment regarding the DSO cost forecast in the consultation report has been unclear. For clarification, USS in the Consultation Report has forecast the increase of DSO and TSO costs in line with the increase of USS. Whereas, in this document USS presents them as forecast by the ERO in the Consultative Report for extraordinary review.

#### IV. Proposal for Maximum Allowed Revenues for the USS for 2022

The following table summarizes the MAR required by USS for 2022, after considering all the necessary adjustments, as argued above.

MAR of Universal Service Supplier for 2022	Unit	Proposal ERO	Proposal USS
<b>Indexation parameters</b>			
Interests rate $I_t$	%	5.53%	5.53%
<b>Retail costs of the Supplier</b>			
OPEX - $OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.29	5.42
Deprecation - $DEPCt = DEPCt-1 * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.11	0.11
<b>Pass-through costs</b>			
TSO costs	€m	18.34	18.34
DSO costs *	€m	174.50	174.50
RES Fund**	€m	3.54	3.54
<b>Working capital (WCLCt)</b>			
$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	2.22	2.31
<b>Energy purchase costs</b>			
Wholesale energy purchase costs	€m	186.10	203.30
<b>Licensing tax</b>			
Licensing tax	€m	0.07	0.07
<b>Bad dept (BDTA)</b>			
BDTA	%	2.4%	2.4%
BDTA	€m	12.52	13.13
<b>Adjustments</b>			
Adjustments 2021	€m	43.56	47.44
Adjustments for OPEX	€m	0.42	0.42
<b>Adjustments of revenues for USS</b>			
USS MAR $AAC_{at-1}$	€m	446.67	468.46
Actual revenues from billing $ARR_{t-1}^{***}$	€m	314.33	319.82
<b>Adjustments of revenues <math>ADJ_t</math></b>	<b>€m</b>	<b>446.67</b>	<b>468.60</b>



Ndërtesa e Elektrokosoves    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Klinton nr.3    *Bill Clinton Boulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*

In order to reflect the expected costs necessary for the safe operation of USS, € 468.59 million are needed. Expected revenues from sales with actual tariffs are € 319.82 million, so the system needs a tariff increase of 47% on average.

Any reflection lower than the required costs will jeopardize the sustainable operation of USS, which during 2021 has already faced liquidity problems.